



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK**

Nr. 842/3 Prot.

Tiranë, më 17.03 2023

VENDIM

Nr. 41 dt. 17.03 2023

**“PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE FORMËS SË DIPLOMËS DHE
SUPLEMENTIT, PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”
NË “TRAJNER I PËRGATITJES FIZIKE” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
LËVIZJES”**

Në zbatim të nenin 3 pika 2 gërma b, 38, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr.11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës”, në nenin 20, 81 pika 2 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën përcjellëse nr.808 prot., datë 13.03.2023 “Përcjellje për miratim e përmbajtjes dhe formës së diplomës dhe suplementit për programin e ciklit të dytë të “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike”, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.03.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e përmbajtjes dhe formës së diplomës në:
 - “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike”
 - Suplementit të Diplomës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes (formatet bashkëngjitur)
2. Ky vendim t’i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. AGRON KASA

